

Lindë edhe një institut shqiptar në Zvicër

Publikuar/modifikuar 17/11/2010 09:49:00



Në Lozanë të Zvicrës, është mbajtur një Simpozium shkencor me temë: Integrimi i shqiptarëve në Zvicër, me një qasje krahasimore me komunitete tjera. është organizuar nga Instituti Zviceran i Studimeve Shqiptare (ISEAL), në partneritet me Observatorin Universitar të Qytetit dhe të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Universitetit të Lozanës (Observatoire Universitaire de la Ville et du Développement Durable).

Me këtë, bashkatdhetarët tanë në Zvicër kanë fituar edhe një institut të rëndësishëm shqiptar të themeluar nga drejtori i tij, shkrimtari i pasionuar, Driton M. Kajtazi, profesor në një kolegji të Kantonit Vaud.

Në qendër të vëmendjes kanë qenë tri tema: Formimi, pjesëmarrja shoqërore dhe Ekonomia dhejeta shoqërore.

Me pjesëmarrjen dhe me paraqitjet e tyre simpoziumin e nderuan edhe katër personalitete publike zvicerane: këshilltari i shtetit - Philippe Leuba (PLR), shef i Departamentit të Brendshëm të Kantonit Vaud, zonja Alice Glauser (UDC-SVP) - anëtare e Parlamentit Zviceran, zonja Ada Marra (PS), - anëtare e Parlamentit Zviceran si dhe z. Antonio Hodgers (PGJZ) - anëtar i Parlamentit Zviceran. Simpoziumi ishte i përkrahur nga: Konfederata Zvicerane (Zyra Federale e Migrimit); Kanton Vaud (Zyra Kantonale për Integrimin e të Huajve dhe Parandalimin e Racizmit), Kryqi i Kuq Zviceran, qytetet: Lozanë, Renens dhe Vevey; Lotaria Romande dhe Pour-cent culturel Migros. "Institutin u themelua në bazë të simpatisë së madhe që kanë shqiptarët e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Luginës së Preshevës, ndaj shtetit zviceran. Qëllimi i Institutit nuk do të jetë vetëm informimi dhe përshkrimi, por prodhimi dhe veprimi në tri fusha: në arsim, hulumtim dhe publikime", ka deklaruar zotëri Kajtazi, për të përditshmen zvicerane "24 Heures". (e.gashi)